




REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE



Nr. 195 Prot

Nr 1450 Prot dt. 07.11.2022

MARRËVESHJE

E lidhur sot më datë, 07.11.2022

NDËRMJET:

KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
përfaqësuar nga Komisionieri, **Z. ROBERT GAJDA**

DHE

KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBËTARE
përfaqësuar nga Kryetarja, znj. Konstantina BEZIANI,

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komitetit për Pakicat Kombëtare, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës së institucioneve nëpërmjet garantimit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit. Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë datë 21.12.2018, Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe institucioni i Komitetit për Pakicat Kombëtare ushtrojnë funksionet e tyre, në ambientet e ish godinës së Ministrisë së Mjedisit, rruga e Durrësit Tiranë. Konkretisht Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ushtron funksionet në katin përdhe dhe katin e parë të godinës, dhe Komiteti për Pakicat Kombëtare në katin e tretë të saj. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke marrë në



konsideratë kërkesën e Komitetit për Pakicat Kombëtare, për mundësinë e vënies në dispozicion të ambjenteve, lidh këtë marrëveshje me objekt si më poshtë.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Vënia në dispozicion nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në favor të Komitetit për Pakicat Kombëtare, të 4 (katër) ambjenteve, zyra.

Konkretisht 2 ambjente (zyra) në katin përdhe me hyrje nga dera kryesore dhe 2 ambjente (zyra) me hyrje te vecantë në anë të godinës ku ushtron veprimtarinë Komisionieri.

Neni 4

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në dispozitat e Kushtetutës, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe Ligjit 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave Kombëtare”.

Neni 5

Detyrimet e Palëve

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje palët marrin përsipër këto detyrime :

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vë në dispozicion të institucionit të Komitetit për Pakicat Kombëtare, katër ambjente, zyra, sipas përshkrimit në nenin.1.

Komiteti për Pakicat Kombëtare merr përsipër të përmbushë të gjitha detyrimet në lidhje me shpenzimet konsumative mujore të energjisë elektrike në ambientet e vendosura në dispozicion.

Neni 6

Kushtet e Pagesës

Çdo pagesë duhet bërë në përfundim të çdo muaji. Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, **brenda 30 ditëve** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek**, dhe kalimi i shumës sipas konsumit mujor do të kryhen nëpërmjet Thesarit me faturë arkëtimi.

Neni 7

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e kësaj marrëveshjeje.



Neni 8
Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit dhe është me afat 2 vjetar me të drejtë rinovimi.
2. Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo Kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 30 ditë para me shkrim Palën tjetër.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do zgjidhet me diskutim dhe mirëkuptim midis palëve, në të kundërt do u nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj prej palëve.

Kjo marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të nënshkruara nga të dy palët dhe me efekte ligjore të njëjta.

Pasi lexohet, ajo nënshkruhet me vullnet të lirë e të plotë nga të dyja palët, sot më datë

KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE

KONSTANTINA BEZIANI



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

ROBERT GAJDA



